



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:234332

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519149

P.nr.778/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. D. nga fshati P., për shkak të veprës penale kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr...../2023, të datës 27.10.2023, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shenjën PP.II.nr...../2023, të dt.27.10.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shenjën PP.II.nr..../2023, të dt.27.10.2023, andaj kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari S. D., nga babai Z., i lindur me datë, në Gjilan, me vendbanim në fshati P., K. Partesh, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 23.10.2023, rreth orës 22:05 minuta, në fshatin Muçibabë, komuna e Gjilanit, patrulla e policisë kufitare SPMK-së Gjilan, ka ndalur për kontroll automjetin furgon të markës „R.”, me tabela VR-...-.. dhe gjatë kontrollimit, është vërejtur se i njëjti kishte të ngarkuar 68 (gjashtëdhjetë e tetë) arka birra të Zajeqarit me nga 20 shishe secila shishe në sasi nga 0.5L, 3 (tre) komplete Coca Cola me nga 9(nëntë) shishe, secila shishe në sasi nga 1.5L, 3 (tre) komplete ujë i thjeshtë Rosa me nga 8 (tetë) shishe, secila shishe me sasi nga

1.5 L, 3 (tre) komplete ujë mineral Bivoda me nga 6 (gjashtë) shishe, secila shishe në sasi nga 1 L, 1 dhe (një) komplet Fanta me nga 9 (nëntë) shishe, secila shishe me sasi nga 1.5 L, për të cilat nuk posedonte dokumentacion për transportimin e mallit dhe prejardhjen e mallit, i cili mall në territorin e Republikës së Kosovës është futur rrugëve ilegale nga Republika e Serbisë, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij me qëllim të shmangies të kontrollit doganor, ka bërë bartjen e mallit përmes rrugëve ilegale - malore, e që shuma e detyrimeve doganore, sipas vlerësimit të doganës, është 106 euro e 91 cent;

-Me këtë ka kryer veprën penale, mashtrimi, nga 323 paragrafi 5 të KPRK-ës.

Prandaj, në bazë të nenit 4,38,39,40 dhe 43 të KPRK-ës si dhe të nenit 495 par. 1.1 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që i akuzuari S. D., dënohet me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind -euro) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet- euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet-euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 311 paragrafi 6 të KPRK-ës, **KONFISKOHET** malli i kontrabanduar i cili pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20 €, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.10.2023, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.../2023, kundër të akuzuarit S. D. nga fshati P., për shkak të veprës penale kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-ës, dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me

besueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së të KPPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si vijon: raporti fillestar i incidentit me nr. 2023-YEC-..., i datës 23.10.2023, deklarata e të pandehurit S. D., kërkesa për sekuestrim të përkohshëm të mallit e dt. 24.10.2023, vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i dt. 23.10.2023, vlerësimi i shmangies doganore nga Administrata ZD Dheu i Bardhë, formulari i pranimit-dorëzimit të rastit nga Menaxhimi i Integruar i Kufirit, informacionet nga data-baza e policisë për të pandehurin, kopje nga kartelat e identitetit për të pandehurin, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, raporti i oficerit F. C., si dhe shkresa tjera përcjellëse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1 të KPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 495 paragrafi 1,2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
Me datë 21.03.2024

Gjyqtarja
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqes kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.*